



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 142, Datë 06.06.2022

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “VOKOPOLA ENERGJI” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET “VOKOPOLA 1”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 274 KW, “VOKOPOLA 2”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 3104 KW, DHE “VOKOPOLA 3”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2297 KW, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 5675 KW**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.06.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 866/10, datë 02.06.2022 të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizime dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Vokopola Energji” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Vokopola 1”, me kapacitet të instaluar 274 kW, “Vokopola 2”, me kapacitet të instaluar 3104 kW dhe “Vokopola 3”, me kapacitet të instaluar 2297 kW, me kapacitet total të instaluar 5675 kW”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “Vokopola Energji” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 471 prot., datë 06.04.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC-et “Vokopola 1”, “Vokopola 2” dhe “Vokopola 3”, me vendodhje në lumin e Vokopolës. Me vendimin e bordit nr. 83, datë 20.04.2022 është marrë vendimi për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Vokopola Energji” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. Pas kësaj vendimmarrje ERE me shkresën nr. 70/15 prot., datë 22.04.2022 bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve nga palët e treta deri më datë 10.05.2022, nuk rezultoi të kishte të tilla.
- Në ERE ka mbërritur shkresa nr. 471/2 prot., datë 03.06.2022, nëpërmjet së cilës shoqëria “Vokopola Energji” sh.p.k. ka depozituar dokumentacionin në lidhje me aplikimin e saj.
- Sa më sipër vlerësohet se nevojitet më shumë kohë për të shqyrtuar këtë dokumentacion dhe për të paraqitur më pas në bord relacionin me propozimin përfundimtar në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Vokopola Energji” sh.p.k., për t’u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Në të tilla rrethana, vlerësohet zgjatja me 20 (njëzetë) ditë pune e afatit të vendimmarrjes finale të bordit të ERE-s, në mbështetje të nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të zgjasë me 20 (njëzetë) ditë pune vendimmarrjen e bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Vokopola Energji” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Vokopola 1”, me kapacitet të instaluar 274 kW, “Vokopola 2”, me kapacitet të instaluar 3104 kW dhe “Vokopola 3”, me kapacitet të instaluar 2297 kW, me kapacitet total të instaluar 5675 kW.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**